

Vendim nr. 307, datë 26.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 26.11.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (V) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: VILSON BRAHAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-276, datë 18.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht për një ngjarje të ndodhur në datën 27.07.2018 në Tiranë. Lidhur me këtë ngjarje, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 28.02.2019 ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 5983/2018 që i përket kërkuesit, i cili është akuzuar për kryerjen e veprave penale “Shkatërrimi i pronës me eksploziv” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 152, paragrafi 1 dhe 278, paragrafi 1, të Kodit Penal (KP). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 28.03.2019, ka pranuar kërkesën e prokurorit dhe e ka dërguar çështjen për gjykim pranë gjykatës kompetente.

2. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallën e parë kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm personalisht, duke deklaruar se do të përfaqësohej nga avokati i tij. Nëpërmjet avokatit, kërkuesi ka bërë kërkesë për gjykim të shkurtuar, e cila është rrëzuar nga gjykata me vendimin e ndërmjetëm të datës 27.05.2019, pasi ka çmuar se çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet. Për këtë arsye, ajo gjykatë ka proceduar me marrjen e provave të paraqitura nga avokati i viktimës, ka pyetur në cilësinë e dëshmitarit viktimën e veprës penale, shtetasen Sh.D. dhe vajzën e saj, si dhe ka bërë pyetje sqaruese për ekspertin antiexploziv, ekspertin kimist dhe ekspertin vlerësues kontabël. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në seancën e datës 17.12.2019, prokurori i çështjes i ka kërkuar gjykatës që në bazë të nenit 372 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) të ndryshojë akuzën lidhur me veprën kryesore nga “Shkatërrimi i pronës me eksploziv” në “Vrasje me paramendim”, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 78, pika 1 dhe 22 të KP-së. Në vijim, avokati i kërkuesit ka kërkuar kohë për mbrojtjen, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata e shkallës së parë (gjyqtari monokratik). Për shkak të akuzës së re, trupi gjyqësor është plotësuar me tri gjyqtarë dhe shqyrtimi gjyqësor ka filluar nga fillimi, duke u gjykuar me gjykim të zakonshëm. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 737, datë 14.04.2020, ka deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim”, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi 1 dhe 22, të KP-së dhe e ka dënuar me 15 vjet burgim për këtë veprë, si dhe për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”, të parashikuara nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së dhe e ka dënuar me 5 vjet burgim për këtë veprë. Në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të KP-së, ajo gjykatë e ka dënuar përfundimisht kërkuesin me një dënim të vetëm prej 16 vjetësh burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur apel kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 152, datë 07.04.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 737, datë 14.04.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndër të tjera, ajo

gjykatë ka arsyetuar se vendi ku është vendosur lënda eksplozive ka qenë dhomë ndenjeje dhe nisur nga këto rrethana, si dhe pasojat që kanë ardhur apo mund të kishin ardhur, del i qartë qëllimi i të pandehurit për të cenuar jetën e personave që banonin në atë banesë dhe jo për të shkaktuar dëme materiale. Në individualizimin e dënimit në rastin konkret ajo gjykatë ka marrë në konsideratë (i) llojin dhe kufijtë e dënimit të parashikuar në dispozitën ligjore konkrete; (ii) faktin se pavarësisht se vepra ka mbetur në tentativë, shkalla e afërsisë së pasojave ka qenë shumë e madhe; (iii) rrezikshmërinë shumë të lartë shoqërore të dy veprave penale, nisur nga sanksioni që parashikohet për secilën prej tyre, si dhe pasojat që kanë sjellë dhe që mund të sillnin; (iv) rrezikshmërinë e autorit të veprës penale, që lidhet me personalitetin e tij, i cili rezulton të jetë i dënuar më parë; (v) aktin që vepra penale është kryer me dashje direkte, që është forma më e rëndë e fajit; (vi) praninë e disa rrethanave rënduese, pasi i pandehuri rezulton përsëritës dhe veprën e ka kryer duke përdorur lëndë plasëse.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-276, datë 18.02.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

5. Në datën 05.08.2025 kërkuari i është drejtuar, nëpërmjet shërbimit postar, Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 22.09.2025.

II

Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

6.1. Cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

6.1.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk mund të veprojë si gjykatë fakti. Ajo gjykatë ka cituar vendimet e gjykatave të faktit dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim si ato për sa u përket fakteve dhe provave.

6.1.2. *E drejta për t'u njoftuar*, sepse Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuarin për zhvillimin e gjykimit.

6.1.3. *E drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar*, pasi kërkuari nuk i është dhënë mundësia të mbrohet ndaj ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe nuk

i është komunikuar akuza për veprën e re penale, për të cilën është dënuar dhe që është e ndryshme nga ajo që ka kërkuar organi i akuzës në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim. Nëse do të ishte zbatuar neni 375, pika 2, i KPP-së, kërkuesi do të kishte garanci ligjore dhe barazi armësh në gjykim. Në këtë mënyrë është cenuar edhe *parimi i barazisë përpara ligjit*. Kërkuesi ka rezervuar të drejtën të shprehet në fjalën e fundit të mbrojtjes dhe nuk është paraqitur në seancë për shkak të frikës nga pandemia, rrethanë kjo që nuk është marrë parasysh nga gjykata e apelit.

- 6.1.4. *Parimi i mosdënimit pa ligj*, pasi gjykata e shkallës së parë ka refuzuar padrejtësisht kërkesën për gjykim të shkurtuar, në kundërshtim edhe me praktikën gjyqësore, duke i mohuar kërkuetit një favor të dhënë nga ligji, uljen me 1/3-ën e dënimit. Ajo gjykatë nuk ka arsyetuar se cili nen i KPP-së ka qenë pengesë për pranimin e kërkesës. Kjo shkelje nuk është riparuar nga gjykatat më të larta. Gjukata e apelit është përpjekur të argumentojë qëndrimin e mbajtur, ndërsa Gjukata e Lartë, megjithëse kishte për detyrë të verifikonte dhe kontrollonte zbatimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta, ka heshtur në lidhje me shkeljet e lejuara nga ato gjykata.
- 6.1.5. *Parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues*, i garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës, pasi për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve” në ngarkim të kërkuetit, gjykatat nuk kanë mbajtur parasysh parimin e sanksionuar në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ligji, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale. Në rastin konkret, gjykatat e faktit e kanë dënuar kërkuetin me 5 vjet burg, duke mos marrë parasysh favorizimin që i bën neni 3 i KP-së.
- 6.1.6. *Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (reformatio in peius)*, pasi prokurori i çështjes ka kërkuar ndryshimin e akuzës kryesore në ngarkim të kërkuetit nga “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, të parashikuar nga neni 151, pika 1, i KP-së, në “Vrasja me paramendim”, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 78 dhe 22 të KP-së. Prokuroria dhe gjykatat kanë gabuar në kualifikimin ligjor dhe në vlerësimin objektiv të provave, pasi gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk doli asnjë fakt ndryshe ose i ri nga çfarë ishte përshkruar në kërkesën për gjykim.

Gjykata e shkallës së parë duhet të kishte bërë ballafaqim të deklarimeve, me qëllim saktësimin e së vërtetës.

6.1.7. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është kufizuar vetëm në evidentimin e shkaqeve të rekursit, duke mos u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve ligjore dhe kushtetuese të kërkuarit. Ajo gjykatë i është referuar nenit 407 të KPP-së, por duke ndryshuar përmbajtjen e tij. Vendimet e gjykatës së apelit dhe të shkallës së parë janë marrë në kundërshtim të hapur me ligjin dhe provat. Vendimi i gjykatës së apelit, që ka dhënë një masë dënimi më të lartë për kërkuarin, është i padrejtë si për sa i përket fajësisë, ashtu edhe për sa i përket masës së dënimit, pasi ajo gjykatë nuk ka marrë parasysh faktin se fashikulli i gjykimit nuk ka asnjë provë ose indicie që të çojë në fajësinë e kërkuarit apo implikimin e tij me personat e tjerë të pandehur në një proces tjetër gjyqësor.

6.1.8. *E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim rekursin e kërkuarit pas përreth 5 vjetësh.

6.2. Shfuqizimin e nenit 375, pika 1, të KPP-së, për shkak se bie në kundërshtim me nenin 31, shkronjat “a” dhe “b”, të Kushtetutës. Ky nen cenon të drejtën për t'u mbrojtur dhe lë vend për abuzim nga gjykata, pasi sipas kësaj dispozite gjykata nuk njofton dhe nuk i jep kohë të akuzuarit për t'u mbrojtur në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale. Ndërsa pika 2 e të njëjtit nen parashikon njoftimin e palëve për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe u jep kohën e nevojshme për t'u mbrojtur. Në këtë kuptim, kjo mospërputhje midis pikave 1 dhe 2 të këtij neni, nuk garanton barazinë përpara ligjit, pasi i mohon të akuzuarit të gjitha të drejtat procedurale dhe materiale të parashikuara nga pika 2.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuarit*

7. Çështja e legjitimitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor apo akti publik që

cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren, së pari, se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka paraqitur dy kërtime: (i) shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, duke ngritur në përmbajtje të ankimit edhe pretendime për vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit (kërkimi i parë); (ii) shfuqizimin e paragrafit 1 të nenit 375 të KPP-së (kërkimi i dytë).

9. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, Gjykata ka pohuar se kërkuesi legjitimohet nëse plotëson bashkërisht këto kriteret: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (shih vendimet nr. 4, datë 21.01.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

10. Për qëllime të legjitimitimit në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, në rastin e pretendimeve për papajtueshmëri të ligjit me Kushtetutën, kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes dhe se zbatimi i dispozitave të ligjit të kundërshtuar cenon interesat e tij, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale. Kërkuesi mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje nëse atij i kërkohet të modifikojë sjelljen e tij ose rrezikon të procedohet për mosrespektim të ligjit (shih vendimin nr. 1, datë 25.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Në zbatim të standardeve kushtetuese të lartpërmendura, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, për kërkimin e parë lidhur me shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, pasi ai kundërshton procesin gjyqësor, në të cilin është vendosur fajësia dhe dënimi penal i tij, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kërkimin e dytë, Kolegji vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e paragrafit 1 të nenit 375 të KPP-së, i cili parashikon se me vendimin përfundimtar gjykata mund

t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose viktima akuzuese, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj. Këtë pretendim ai e ka mbështetur në argumentin se në gjykimin në shkallë të parë prokurori që ka zëvendësuar prokurorin që ka paraqitur kërkesën për gjykim, ka ndryshuar akuzën e të pandehurit nga "Shkatërimi i pronës" në "Vrasja me paramendim", të mbetur në tentativë. Në ndryshim nga sa parashtron kërkuesi, Kolegji vlerëson se nuk ndodhemi para situatës juridike të parashikuar nga neni 375 i KPP-së që parashikon ndryshim të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata, por ndodhemi në situatën që prokurori ka vlerësuar se fakti penal i dalë nga shqyrtimi gjyqësor ndryshon nga fakti penal i përshkruar në kërkesën për gjykim dhe ka ndryshuar akuzën ndaj të pandehurit sipas përcaktimeve të nenit 372 të atij kodi. Për më tepër, edhe prokurori që ka kërkuar ndryshimin e akuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallën e parë, ka përdorur si bazë ligjore në mbështetje të kërkesës së tij nenin 372 të KPP-së dhe jo nenin 375 të atij kodi. Në situatën kur dispozita e kundërshtuar nuk është zbatuar në procesin penal të kërkuetit, ajo nuk e prek atë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale, për sa kohë nuk është provuar se sjell ndonjë pasojë në drejtim të të drejtave të tij kushtetuese. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për këtë kërkim. Në këto kushte, Kolegji do të vijojë analizën e pretendimeve të kërkuetit vetëm për kërkimin e parë.

13. Lidhur me kriterin për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, për sa u përket kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se individit duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e neneve 399/2 e vijues të KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Lidhur me pretendimin e kërkuetit për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, me argumentin se gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ka zgjatur rreth 5 vjet, sillet në vëmendje se neni 399/6 i Kodit të Procedurës Civile (KPC) parashikon se në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë, kërkesa shqyrtohet nga një kolegji tjetër i asaj gjykate. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se kërkuesi i ka pasur të gjitha mundësitë t'i drejtohet Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, ndërkohë që nuk rezulton që ai të ketë paraqitur ndonjë kërkesë të tillë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këtë pretendim kërkuesi

nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, rrjedhimisht ai nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Për sa u takon pretendimeve të tjera, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, ose i ka lidhur me procesin në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues, për rrjedhojë ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion për to.

16. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar me vendimin e datës 18.02.2025 të Gjykatës së Lartë, i cili, sipas informacionit të kësaj të fundit, është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 04.04.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 05.08.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime për cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t’u njoftuar, për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe asaj për t’u mbrojtur, parimit të mosdënimit pa ligj, atij të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformatio in peius*) dhe standardit të arsytimit të vendimit.

18. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar atë për zhvillimin e gjykimit, duke i cenuar të drejtën për t’u njoftuar. Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka evidentuar rëndësinë e së drejtës për t’u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, e cila u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016; nr. 21, datë 04.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim, nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit të këtij ankimi kushtetues, Kolegji vëren se më 14.01.2025 Gjykata e Lartë ka publikuar në faqen e saj zyrtare planifikimin e shqyrtimit në dhomën e këshillimit të çështjes penale që i përket kërkuesit. Për më tepër, po në të njëjtën datë, administrata e asaj gjykate ka njoftuar edhe individualisht nëpërmjet adresës elektronike avokaten e kërkuesit për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit. Në këto kushte, Kolegji çmon se ajo gjykatë i ka garantuar kërkuesit të drejtën për t’u njoftuar rregullisht, për rrjedhojë ky pretendim është haptazi i pabazuar.

19. Pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, Kolegji vëren se kërkuesi e ka mbështetur në argumentin se Gjykata e Lartë ka vepruar si gjykatë fakti, pasi ka cituar vendimet e gjykatave të faktit dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim si ato për sa u përket fakteve dhe provave. Ky argument i vetëm, në çmimin e Kolegjit, nuk është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, ndaj edhe ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar edhe e drejta për t'u mbrojtur, pasi atij nuk i është dhënë mundësia të mbrohej ndaj ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe nuk i është komunikuar akuza për veprën e re penale, për të cilën është dënuar dhe që është e ndryshme nga ajo që ka kërkuar organi i akuzës në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim. Nëse do të ishte zbatuar neni 375, pika 2, i KPP-së, kërkuesi do të kishte garanci ligjore dhe barazi armësh në gjykim dhe në këtë mënyrë nuk do të cenohej edhe *parimi i barazisë përpara ligjit*. Sipas kërkuesit, ai ka rezervuar të drejtën të shprehet në fjalën e fundit të mbrojtjes dhe nuk është paraqitur në seancë për shkak të frikës nga pandemia, rrethanë kjo që nuk është marrë parasysh nga gjykata e apelit.

21. Lidhur me të drejtën e mbrojtjes në procesin penal, Gjykata ka pranuar se ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore, Kolegji vëren se gjatë gjykimit në shkallën e parë kërkuesi ka qenë i pranishëm në seancën e datës 09.05.2019, ndërsa në seancat vijuese ai nuk është paraqitur, duke deklaruar me shkrim përpara çdo seance se dëshiron të përfaqësohet nga avokati i tij. Në seancën e datës 17.12.2019, në të cilën prokuroria ka kërkuar ndryshimin e akuzës, kërkuesi dhe avokati i tij kanë qenë të pranishëm. Ky i fundit ka kërkuar kohë për të përgatitur mbrojtjen për akuzën e re, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata e shkallës së parë dhe më pas është vijuar me plotësimin e trupit gjykues edhe me dy gjyqtarë të tjerë. Pas rifillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkuesi është paraqitur vetëm në dy seanca, konkretisht ato të datës 30.12.2019 dhe 30.03.2020 dhe gjatë kësaj të fundit ka refuzuar që t'u përgjigjet pyetjeve të prokurorit, ndërsa gjatë seancave të tjera kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm, por ka qenë i përfaqësuar nga avokati i tij. Gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, Kolegji vëren se seancat gjyqësore janë shtyrë pesë herë

me kërkesë të kërkuarit ose mbrojtësit të tij dhe se përkundër asaj që pretendon kërkuari, ai ka qenë i pranishëm në seancën e datës 13.03.2021 në gjykatën e apelit, ku ka deklaruar se është dakord me mbrojtësin. Ky i fundit ka parashtruar se gjykata dhe prokuroria kanë gabuar në kualifikimin ligjor të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri dhe se këtij të fundit i është mohuar dy herë e drejta për gjykim të shkurtuar, duke kërkuar përfundimisht prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim ose ndryshimin e vendimit. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuarit nuk i është cenuar ose penguar e drejta për një mbrojtje efektive nga gjykatat e faktit, por, përkundrazi, gjykata e shkallës së parë i ka dhënë kohën e nevojshme mbrojtësit të kërkuarit për të përgatitur mbrojtjen sipas akuzës së re dhe shqyrtimi gjyqësor ka filluar nga fillimi. Ndërsa gjykata e apelit, në situatën në të cilën kërkuari ka kërkuar shtyrje të seancës gjyqësore për shkak të gjetjes së një mbrojtësi tjetër, e ka pranuar çdo herë atë kërkesë duke marrë masat ligjore për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, me qëllimin për t'i dhënë mundësinë për të pasur një mbrojtje reale, në respektim edhe të parimit të barazisë së armëve. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur është haptazi i pabazuar.

23. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *parimit të mosdënimit pa ligj*, Kolegji vëren se kërkuari e ka lidhur me mospranimin e kërkesës së tij për gjykim të shkurtuar, duke pretenduar se atij i është refuzuar padrejtësisht kërkesa për gjykim të shkurtuar edhe pse nuk është sjellë asnjë provë e re, përveçse janë pyetur oficerët e Policisë Gjyqësore, duke i mohuar atij një favor të njohur nga ligji, uljen e 1/3-ës së dënimit.

24. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, për sa i takon rritit procedural të gjykimit të shkurtuar, Gjykata ka pohuar se ai (gjykimi i shkurtuar) nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit dhe në rast se ai ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që të rrëzojë kërkesën e të pandehurit (*shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa në lidhje me karakteristikat e gjykimit të shkurtuar, i cili hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të

zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime për këtë vlerësim, mund të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit për gjykim të shkurtuar, pasi ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që ishin aktet dhe provat e fashikullit të prokurorit. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se ajo gjykatë ka proceduar me marrjen e provave të paraqitura nga mbrojtësi i viktimës, ka pyetur në cilësinë e dëshmitarit viktimën e veprës penale, shtetasen Sh.D. dhe vajzën e saj, ka bërë pyetje sqaruese për ekspertin antiexploziv, ekspertin kimist dhe ekspertin vlerësues kontabël. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka theksuar se gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili mund të refuzojë kërkesën nëse mendon se është i nevojshëm një proces i mirëfilltë penal, ka arsyetuar se në çmimin e gjykatave të faktit çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që ishin aktet.

26. Për sa më sipër dhe nën dritën e standardeve të mësipërme kushtetuese, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj për shkak të mospranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, është haptazi i pabazuar.

27. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (reformatio in peius)*, kërkuesi ka argumentuar se prokurori i çështjes ka kërkuar ndryshimin e akuzës kryesore në ngarkim të kërkuesit nga shkatërrimi i pronës me eksploziv në vrasje me paramendim, e mbetur në tentativë. Në këtë drejtim, sipas tij, prokuroria dhe gjykata kanë gabuar në kualifikimin ligjor dhe në vlerësimin objektiv të provave, pasi gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka dalë asnjë fakt ndryshe ose i ri nga çfarë është përshkruar në kërkesën për gjykim. Gjykata e shkallës së parë duhet të kishte bërë ballafaqim të deklarimeve, me qëllim saktësimin e së vërtetës.

28. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i mosrëndimit të pozitës së palës që vë në lëvizje gjykatën me ankim, i njohur si *reformatio in peius*, është parë në këndvështrim të garantimit të të drejtave të të pandehurit në procesin penal. Ky rregull është i parashikuar në mënyrë të shprehur

në KPP dhe e ndalon gjykatën që të caktojë një dënim më të rëndë nga ai i caktuar me vendimin e kundërshtuar kur apelues është vetëm i pandehuri. Gjykata ka vlerësuar se megjithëse Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues dhe është konsideruar si një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës më të lartë, e cila merr rëndësi në një shoqëri demokratike dhe për këtë arsye askush nuk mund ta humbasë këtë përparësi. Ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta, vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Parë nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit *reformatio in peius* përbën njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 15, datë 17.04.2008; nr. 13, datë 15.04.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, për shkak të ndryshimit të akuzës në ngarkim të kërkuesit nga prokurori i çështjes si rrjedhojë e gabimeve në kualifikimin ligjor dhe në vlerësimin e provave, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka çmuar se arsyetimi i gjykatave më të ulëta në këtë drejtim është i plotë dhe shterues, duke vënë në dukje se sipas tyre fakti penal në ngarkim të kërkuesit gjatë gjykimit ka rezultuar ndryshe nga sa është prezantuar në kërkesën për gjykim, shkak për të cilin prokurori ka ndryshuar akuzën ndaj kërkuesit në përputhje me përcaktimet e nenit 372 të KPP-së. Po kështu, ai kolegji ka vënë në dukje se gjykata e shkallës së parë ka garantuar të drejtën e kërkuesit për të marrë kohën e nevojshme dhe të kërkuar për të përgatitur mbrojtjen. Nën këtë optikë, si dhe bazuar në thelbin e argumenteve të kërkuesit, Kolegji vlerëson se nuk jemi në situatën ligjore të përcaktuar nga jurisprudenca kushtetuese si rëndim i pozitës së të pandehurit/dënuarit. Për më tepër, Kolegji evidenton se neni 372 i KPP-së nuk e ndalon prokurorin që të ndryshojë akuzën gjatë gjykimit.

30. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit*, nisur nga thelbi i argumenteve në mbështetje të tij, Kolegji do ta analizojë në vijim të lidhur me të drejtën e aksesit. Edhe për pretendimin tjetër për cenimin e *parimit të zbatimit të ligjit penal favorizues*, Kolegji vlerëson se *prima facie* përfshihet në juridiksionin kushtetues, ndaj në vijim do ta analizojë për bazueshmërinë në themel.

B Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

31. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë është kufizuar vetëm në evidentimin e shkaqeve të rekursit, duke mos u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve ligjore dhe kushtetuese në të. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë i është referuar nenit 407 të KPP-së, por duke ndryshuar përmbajtjen e nenit. Vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit janë marrë në kundërshtim të hapur me ligjin dhe provat, sipas tij. Ato vendime janë të padrejta, pasi si për sa i përket fajësisë, ashtu edhe për sa i përket masës së dënimit, nuk kanë marrë parasysh faktin se nuk ka asnjë provë apo indicie që të çojë në fajësinë e kërkuesit ose implikimin e tij me personat e tjerë të pandehur në një proces tjetër gjyqësor.

32. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Ndërkohë, neni 142, pika 1, i Kushtetutës parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

33. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në lidhje me standardin e arsytimit, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është edhe e drejta e aksesit në gjykim. Megjithatë, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e

mospranimi të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata, po kështu, në vijimësi ka theksuar se zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Kjo do të thotë se Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në rastin në shqyrtim Kolegji vëren se prokuroria ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të kërkuesit, duke e akuzuar për kryerjen e veprave penale “Shkatërrimi i pronës me eksploziv” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, dhe se gjatë procesit gjyqësor në shkallë të parë prokurori ka ndryshuar akuzën lidhur me veprën kryesore në ngarkim të kërkuesit në “Vrasja me paramendim”, të mbetur në tentativë.

37. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese, Kolegji do të analizojë nëse arsyetimi i vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është mjaftueshëm i qartë në përmbajtje dhe nëse argumentet e pjesës arsyetuese janë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të tyre, si dhe nëse interpretimi i ligjit nga gjykatat ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues, duke sjellë, si pasojë, për kërkuesin cenimin e së drejtës së aksesit efektiv.

38. Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë e ka deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprave penale të vrasjes me paramendim, të mbetur në tentativë dhe mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve dhe e ka dënuar përfundimisht me 16 vjet burgim. Për sa i përket veprës penale të vrasjes me paramendim, ajo gjykatë ka arsyetuar lidhur me elementet e figurës së asaj vepre dhe ka arritur në konkluzionin se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi e ka kryer veprën penale dhe se duhet të dënohet për këtë vepër. Po kështu, ajo ka vlerësuar se nuk provohet përtej çdo dyshimi se kjo vepër penale është kryer sipas paragrafit të dytë të nenit 78 të KP-së, pra për interes ose hakmarrje, siç kërkohet nga prokurori. Gjithashtu, nuk provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, sipas saj, as bashkëpunimi, pasi mbetet në kuadrin e dyshimit. Edhe për

sa i përket veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje e armëve luftarake dhe municionit, ajo gjykatë ka arsyetuar lidhur me elementet e figurës së veprës dhe ka arritur në konkluzionin se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi e ka kryer atë.

39. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ndër të tjera, lidhur me veprën kryesore në ngarkim të kërkuesit, ajo ka arsyetuar se nisur nga vendi ku është vendosur lënda eksplozive (dhomë ndenjeje) dhe koha e mënyra e përdorur prej tij për kryerjen e veprës penale, si dhe pasojat që kanë ardhur ose mund të kishin ardhur, del i qartë qëllimi për të cenuar jetën e personave që banonin në atë banesë dhe jo për të shkaktuar dëme materiale.

40. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit rekursin e kërkuesit dhe ndonëse ka vlerësuar se ai nuk plotësonte kriteret e pranueshmërisë për shqyrtimin në themel, pasi shkaqet e parashtruara në të janë çmuar si haptazi të pabazuara ose nuk u referohen shkaqeve për të cilat ligji lejon paraqitjen e tij, u ka dhënë përgjigje të detajuar pretendimeve të kërkuesit. Konkretisht, për sa i takon pretendimit të ngritur në rekurs për keqzbatim të nenit 47 e vijues të KP-së për caktimin e masës së dënimit nga gjykatat më të ulëta, në veçanti nga ajo e apelit, ai kolegji ka vlerësuar se në caktimin e masës së dënimit për kërkuesin gjykata e apelit ka marrë parasysh kriteret e zbatimit të nenit 47, kështu që pretendimi i tij nuk qëndron. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit e ka marrë në analizë këtë pretendim dhe, referuar rrethanave të vërtetuara me provat e administruara në këtë proces, të zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, ka arritur në përfundimin se masa e dënimit e caktuar nga gjykata e shkallës së parë për të pandehurin i përgjigjet si rrezikshmërisë shoqërore të tij, ashtu dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të konsumuara.

41. Kolegji Penal në tërësi nuk ka konstatuar mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore ose me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave nga gjykata e apelit ose në kundërshti me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ndërsa për pjesën e pretendimeve në rekurs, që ngre çështje të provave (të shqyrtuara nga gjykatat e faktit), ai kolegji ka vënë në dukje se ajo del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

42. Në këndvështrim të përmbajtjes së pretendimeve të kërkuesit dhe në analizë të vendimeve gjyqësore objekt të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se vendimet e gjykatave të faktit, të cilat janë në një linjë arsyetimi me njëra-tjetrën, kanë vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale si më sipër dhe e kanë dënuar atë me 16 vjet burgim. Ato

gjykata u kanë dhënë përgjigje të argumentuara pretendimeve të kërkuarit për secilin nga shkaqet e rishikimit të pretenduar nga ai. Vendimet gjyqësore në fjalë nuk duken të paqarta në përmbajtje dhe as që argumentet e parashtruara në pjesën arsyetuese të tyre të mos jenë të mjaftueshme për të mbështetur disponimin në pjesën urdhëruese të vendimeve.

43. Po kështu, duke pasur parasysh natyrën e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit është vendosur mospranimi i rekursit në dhomën e këshillimit, rezulton se në të janë listuar shkaqet e parashtruara në rekurs dhe pavarësisht se është vendosur mospranimi i rekursit, arsyetimi i saj nuk duket të jetë i kufizuar, pasi Gjykata e Lartë i ka vënë shkaqet e rekursit në diskutim, duke arritur në përfundimin se rekursi nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato që lejon neni 432 i KPP-së. Për pasojë, Kolegji vlerëson se, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuari, arsyetimi i vendimit nga ajo gjykatë nuk rezulton të jetë në cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor sipas jurisprudencës kushtetuese.

44. Nën këtë optikë, Kolegji vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit të tyre, ndërkohë që interpretimi nga ato i ligjit, i shprehur përmes arsyetimit, nuk duket i paarsyeshëm ose arbitrar, për sa kohë nuk evidentohet ndonjë gabim ligjor ose faktik i dukshëm. Ato gjykata kanë marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimet e kërkuarit në respektim të së drejtës së aksesit në gjykatë. Ndërkohë, pretendimet për interpretimin dhe zbatimin e ligjit, në rastin konkret, janë të natyrës ligjore dhe ato, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës.

45. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues

46. Kërkuari ka pretenduar se për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve” në ngarkim të kërkuarit, gjykatat nuk kanë mbajtur parasysh parimin e sanksionuar në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ligji, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale. Në rastin konkret, gjykatat e faktit e kanë dënuar kërkuarin me 5 vjet burg, duke mos marrë parasysh favorizimin që i bën dispozita.

47. Në lidhje me zbatimin e ligjit favorizues, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se neni 29 i Kushtetutës në pikën 3 parashikon se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

Gjykata është shprehur se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës, ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si e tillë, është e rëndësishme për respektimin e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor. Ky parim gjen zbatim vetëm për ligjet penale, arsye për të cilën dispozita kushtetuese reflektohet në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale (*shih vendimet nr. 2, datë 15.02.2017; nr. 1, datë 20.01.2014; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (*shih vendimet nr. 9, datë 26.02.2016; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar vazhdimisht se sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor dhe se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, interpretimi i ligjit material ose procedural është, së pari, detyrë e Gjykatës së Lartë. Gjykata ndërhyt vetëm atëherë kur, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Kolegji vëren se në kohën e kryerjes së veprës penale, paragrafi 1 i nenit 278 të KP-së parashikonte se kjo vepër dënohej me burgim “nga tre deri në shtatë vjet”, ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 44/2019, datë 18.07.2019, është ndryshuar marzhi i dënimit për këtë vepër duke parashikuar dënimin me burgim “nga pesë deri në shtatë vjet”, pra duke rritur kufirin minimal të dënueshmërisë së kësaj veprë “nga tre deri në pesë vjet” burgim.

50. Po kështu, Kolegji evidenton se në zgjidhjen e çështjes konkrete, gjykata e shkallës së parë e ka deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim”, të mbetur në tentativë, duke e ka dënuar me 15 vjet burgim për këtë vepër, si dhe për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, duke e dënuar me 5 vjet burgim për këtë vepër dhe, në bashkim të dënimeve e ka dënuar përfundimisht kërkuesin me një dënim të vetëm prej 16 vjetësh burgim. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji Penal i Gjykatës

së Lartë ka evidentuar se ligji i kohës së kryerjes së veprës penale nga kërkuesi dhe ligji penal në fuqi në kohën e gjykimit, ishin të ndryshëm, duke qenë dispozitat e këtij të fundit më të favorshme, që në rastin konkret lidheshin me zbatimin e nenit 278, paragrafi 1, të KP-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2019. Pavarësisht kësaj, sipas atij kolegji, gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj, lënë në fuqi nga gjykata e apelit, ka argumentuar proporcionalitetin e masës së dënimit dhe ka vlerësuar se në rastin konkret mbajtja pa leje dhe përdorimi i armëve shpërthyes kanë shërbyer për kryerjen e një vepre penale të rëndë. Po kështu, Kolegji Penal ka evidentuar faktin se dënimi i caktuar nga gjykatat më të ulëta për këtë vepër penale është brenda marzhit të dënueshmërisë së kësaj vepre të parashikuar edhe nga ligji penal favorizues. Për më tepër, sipas atij kolegji, nuk rezulton që ato gjykata të kenë arsyetuar se dënimi i caktuar për këtë vepër duhet të jetë në minimumin e marzhit të dënimit, duke arritur në përfundimin se moszbatimi i dispozitës favorizuese nuk ka sjellë pasoja në dispozitivin e vendimit të gjykatës së apelit (por vetëm në analizë të arsytimit të saj për sa i përket ligjit të zbatueshëm), duke mos e bërë atë të cenueshëm për këtë shkak. Në këtë kuptim, Kolegji Penal nuk ka konstatuar shkelje të zbatueshmërisë së ligjit material favorizues, sipas nenit 3 të KP-së, për shkak të mosardhjes së pasojave në dispozitivin e vendimit.

51. Për sa më sipër, Kolegji evidenton se gjykatat e faktit në dënimin që kanë caktuar përfundimisht për kërkuesin, në përputhje me nenin 55 të KP-së, kanë zbatuar sistemin e dënimit më të rëndë të shtuar (me përthithje), duke i shtuar dënimin të veprës me rrezikshmëri më të madhe (vrasjes së mbetur në tentativë), dënimin për veprën penale dytësore (armëmbajtjen pa leje). Në këtë drejtim, duke pasur parasysh edhe jurisprudencën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimin nr. 00-2023-183, datë 31.01.2023, sipas të cilit dënimi quhet i përshtatshëm për sa kohë që nuk e kalon limitin e parashikuar të dënimit në ligjin penal favorizues dhe, në kushtet kur bashkimi i dënimeve të kërkuesit nuk është një bashkim aritmetik, Kolegji çmon se mosreferimi nga gjykatat e faktit në dispozitën e kohës së gjykimit për veprën penale dytësore nuk ka sjellë pasoja në të drejtat e kërkuesit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues është haptazi i pabazuar.

52. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.